

EM TË MALISHEVËS

ton

Shkatërrimi i trotuareve s'është prioritet i Ekzekutivit

Arian Duriqi

LIPJAN, 9 GUSHT – Një pjesë e madhe trotuaresh në Lipjan po përjetojnë vetëm shkatërrim, ndërsa Ekzekutivi komunal është tërhequr nga rregullimi i tyre që në seancën e fundit të KK-së.

Me gjithë faktin se ka pasur reague publike dhe kërkesa të vazhdueshme, riparim trotuaresh nuk do të ketë sivjet, ndërsa rrezikohet që kjo mos të ndodhë as mot. Shqetësim për gjendjen e trotuareve sërish ka shprehur shoqëria civile e Lipjanit.

Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në OJQ-në YAHR, ka deklaruar të dielën se shkatërrimi i trotuareve midis Lipjanit do të vazhdojë përdërisa pushteti lokal qëndron indiferent dhe nuk reagon në këtë plan.

"Projektet e ndryshme infrastrukturore dhe kompanitë ndërtuese në të kaluarën kanë dëmtuar jo pak trotuaret e Lipjanit. Vjet ishin planifikuar 70 mijë euro për ndërhyrje dhe riparim trotuaresh, por për çudi Ekzekutivi aktual në mbledhjen e fundit të KK-së nëpërmjet votës shumicë që e ka në Kuvend me rishikim buxhetor e ka hequr këtë planifikim dhe ky veprim është për t'u gjykuar nga qytetarët, sepse gjasat tashmë janë të vogla që edhe mot të ketë diçka pozitive në këtë plan", ka thënë Krasniqi.

Për më tepër, me një propozim të Ekzekutivit komunal këshilltarët shumicë të pushtetit në Lipjan në mbledhjen e fundit të KK-së e patën miratuar heqjen e projektit të planifikuar më herët dhe me rëndësi për vetë qendrën e Lipjanit e që ishte

rregullimi i trotuareve në qendrën e qytetit, ndërsa të menjëhershme atëkohë kishin qenë edhe reagimet e opozitës dhe të shoqërisë civile për këtë veprim. Ky veprim i Ekzekutivit dhe i shumicës në KK, nga ana e opozitës, përkatësisht PDK-së, Dega në Lipjan, vlerësohej se dëshmi se kreu komunal, Imri Ahmeti dhe Ekzekutivi i tij nuk e kanë prioritet Lipjanin si qendër në investime.

"Planifikimi që ne si Ekzekutiv e kemi bërë vjet për rregullimin e trotuareve në Lipjan ka qenë planifikim emergjent dhe i nevojës së madhe, sepse disa nga trotuaret në qendër të Lipjanit e kanë gjendjen mjaft të keqe. Megjithatë, pamja e keqe në qendër nuk i ka penguar aspak kreut komunal dhe stafit të tij duke hequr këtë planifikim dhe duke dëshmuar se është qeverisje pa koncept dhe jo për qytetarin, por për interesa të ngushta personale", pati thënë Hoxha në kohën kur miratohej ky projekt për t'u hequr.

Ndërkohë që, autoritetet komunale të Lipjanit nuk e patën komentuar shumë heqjen e këtij projekti në ditën kur votohej rishikimi buxhetor.

Shkëlzen Hajdini, drejtor i Buxhetit, duke prezantuar para këshilltarëve vendimin për rishikimin e buxhetit për 2014, pati deklaruar se për shkak të situatave të reja Ekzekutivi detyrohej ta hiqte nga planifikimi rregullimin e trotuareve. Një qëndrim të njëjtë, ndërkaq, me drejtorin e Buxhetit e ka mbajtur të dielën edhe zëshënësi i kësaj komune, Alban Nuredini.

© KOHA Ditore

© KOHA Ditore